

VENDIM
Nr.198, datë 19.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.320, DATË 19.3.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SISTEMIN E IDENTIFIKIMIT TË KAFSHËVE DHE TË
REGJISTRIMIT TË FERMAVE BLEGTORALE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pikat 6, 7, 38 e 39, 24 shkronja “b”, e 32, pika 6 të ligjit nr.9308, datë 4.11.2004 “Për Shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8702, datë 1.12.2000 “Për identifikimin e kafshëve dhe regjistrimin e fermave blegtorale”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.320, datë 19.3.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4.Kostoja financiare e sistemit të identifikimit të kafshëve dhe të regjistrimit të fermave blegtorale, për pagesën e bazës materiale dhe për pagesën për shërbimin e kryer nga operatorët privatë, mbulohet nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për sistemin e identifikimit të kafshëve.”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5.Pagesa për operatorët privatë bëhet nga buxheti i matrikullimit, planifikuar për vitin 2009, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, për drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, në qarqe, si më poshtë vijon:

a) Për gjedhin, 100 (njëqind) lekë, për çdo kafshë të matrikulluar;

b) Për bagëtitë e imëta, 30 (tridhjetë) lekë, për çdo kafshë të matrikulluar me matrikull individual, dhe 15 (pesëmbëdhjetë) lekë për krerë, për matrikullimin e kafshëve të reja, me destinacion për therje.

Në shërbimin e kryer nga operatori privat përfshihen matrikullimi i kafshës dhe plotësimi e dorëzimi i formularëve respektivë, në drejtoritë rajonale të bujqësisë, ushqimit dhe mbrojtjes së konsumatorit, ku është i kontratuar.”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha